



Prishtinë, 15 tetor 2018
Kodi i ZRRE-së: V_1051_2018

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Duke u bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 9, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7, Neni 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.5, Neni 25, Neni 26 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, Neni 46 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2, Neni 47 dhe Neni 48 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 16 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085);
- Dispozitat e Rregullës për vendosjen e të hyrave të lejuara maksimale të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (Rregulla për Të Hyrat e OSSH-së);
- Parimet për përcaktimin e tarifave për shfrytëzimin e Sistemit të Shpërndarjes dhe taksave të kyçjes;
- Vendimin nr. V_1027_2018 për të Hyrat e Lejuara Maksimale (MAR) për OSSH-ë;
- Metodologjinë për Përcaktimin e Tarifave të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes; dhe
- Aplikacionin/Kërkesën e KEDS SH.A. për aprovimin e tarifave të rregulluara për shfrytëzimin e Sistemit të Shpërndarjes të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, të dorëzuar më datë 02 tetor 2018,

në seancën e mbajtur më 15 tetor 2018 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHEN** - tarifat për shfrytëzimin e Sistemit të Shpërndarjes (KEDS/OSSH) për periudhën 01 tetor 2018-31 mars 2019.
- II. Struktura e tarifave për shfrytëzimin e Sistemit të Shpërndarjes për OSSH, e cila do të zbatohet nga data 01 tetor 2018 është dhënë në tabelën e mëposhtme:

Tarifat për Shfrytëzimin e Sistemit të Shpërndarjes		
Niveli i tensionit	Njësia	Tarifa
35 kV	€/kWh	1.33
10 kV	€/kWh	1.64
0.4 kV	€/kWh	2.53

ARSYETIM


- ✚ ZRRE më datën 02 tetor 2018 ka pranuar aplikacionin për tarifa të rregulluara për shfrytëzimin e Sistemit të Shpërndarjes të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes;
- ✚ ZRRE për vendosjen e tarifave të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, ka marrë parasysh dokumentet e nxjerra dhe të publikuara në faqen zyrtare të saj si në vijim:
- ✚ Raport Konsultativ për të Hyrat e Lejuara Maksimale - Shqyrtimi Periodik për OSSH, i publikuar me datën 24 gusht 2018;
- ✚ Raport Përfundimtar për të Hyrat e Lejuara Maksimale OSSH-ë – Përgjigjet ndaj Komenteve, i publikuar me datën 24 shtator 2018; dhe
- ✚ Bordi i Rregullatorit pas vlerësimit dhe analizimit të raporteve relevante dhe pas shqyrtimit të komenteve të pranura nga palët, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

III. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Rregullatorit, do të zbatohet nga KEDS SH.A. dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data e pranimit të vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhet e fundit.

Bordi i ZRRE-së:


Arsim Janova, u.d kryesues


Besim Sejfiqaj, anëtar


Selman Hoti, anëtar


Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (KEDS), dhe
- Arkivit të ZRRE-së